Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 74-të, të mbajtur më 06.09.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-2632/1 datë 04.08.2021, NDËRPRITET

Konstatohet se në ngjarjen e denoncuar nuk ka veprime të pa lejueshme ose jo ligjore të personit zyrtarë //// në mendim të dispozitave të ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit për arsye se KSHPK nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme.

Lënda me numër 12-2632 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2632/1 të datës 04.08.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet e nxjerra kanë të bëjnë me dyshime për veprime të palejueshme të ///, në lidhje me kalimin e të dhënave nga sistemi i vjetër në sistemin e ri të TI-së të ///, gjegjësisht për dyshime se të dhënat nuk janë dorëzuarë të plota ose janë të dorëzuara në formatin e pakuptueshëm që lënë vend për dyshime nga ana e tijë për marrëveshje plotësuese me /// dhe pagesën e fondeve shtesë nga Buxheti për gjërat e parashikuara me marrëveshjen e mëparshme. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit është dorëzuar komunikimi në formë elektronike me gjyqtarin hulumtues/// në Biron për Ekspertizë Ligjore të RMV-së, në të cilën është nxjerrë kërkesa për ekspertizë të dokumentacionit që lidhet me lëndën, me pyetje të përcaktuara në mënyrë të heshtur, për të cilat personi i kualifikuar duhet të japë një gjetje të kualifikuar dhe opinion, në formën e përgjigjeve.

Pas kontrollit të përmbajtjes së denoncimit KSHPK-ja i u drejtua /// dhe kërkoi informacione për rezultatin e procedurës pas ekspertizës, si dhe të dhëna për masat e marra deri më tani në lidhje me rastin konkret. Përgjigja u dërgua dhe shifet se një ekspert mjeko-ligjor e kishte përgatitur një gjetje dhe opinion profesional që iu dorëzua Avokatit të Shtetit. Në vitin /// , u mbajt takimi midis ///, Avokatit të Shtetit dhe // në të cilin takim u theksua qartë se sipas

kontratave të përfunduara për mirëmbajtjen e sistemeve të TI-së, // nuk ka asnjë detyrim për të dhënë ndonjë dokumentacion.

Nga njoftimi dhe dokumentet e dorëzuara, KSHPK-ja ka konstatuar se pretendimet e denoncimit nuk i referohen veprimeve të paautorizuara ose të paligjshme të zyrtarëve në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, por gjendjeve që rrjedhin nga të drejtat dhe detyrimet e rregulluara në mënyrë të pamjaftueshme nga kontratat aktuale dhe për këtë arsye KSHPK-ja ka vendosur si në dispozitivin e Vendimit.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: K.N.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska